

“Mjedisi Sot”
Nr 2195 E Hene 17/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDi

- Liqeni i Shkodres, me “i harruari” ne ballkan
- Ndotja e ujit, 5 mije banore ne rrezik epidemie
- Vlore, qytetaret ne proteste kunder petroliferes
- Kruje, fushat e gelqeres, rrezik per banoret
- “Iargoni mbeturinat se u semurem”

NGA BOTA

- Ozoni, rikuperim nga mesi i shekullit
- Distanca minimale fushes se misrit omgj nga misri tjeter 150 - 300 metra
- Shkrin akulli, hapet korridori detar ne arktik

Njoftime

- REC Shqiperi: Vend pune prane projektit te Liqenit te Shkodres
- Seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit
- Konferenca mbi strategjine ndersektoriale per zhvillimin rajonal

- Earthcorps International Program - International outreach trainer position announcement
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitetet per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

LIQENI I SHKODRES, ME "I HARRUARI" NE BALLKAN

Ritvan Dibra, gazeta Panorama, fq. 10

Mjafton te afroresh ne hyrje te qytetit te Shkodres, ne te ashtuquajturen shetitore, per te ndier eren e keqe qe kundermon dhe te ze frymen. Deri para pak muajsh, ne kete zone jane derdhur gjithë ujerat e zeza te qytetit. Megjithese tashme ky problem eshte zgjidhur dhe ujerat e zeza derdhen gjetke, ndotja eshte e madhe. Kjo per faktin se ujerat e pista te grumbulluara prej vitesh kane krijuar keneten e tyre. Vetem nje nderhyrje totale mund te rehabilitoje e t'i ktheje "shendetin" e humbur kesaj pjese te liqenit. Por mesa duket, askujt nuk i bie ndermend te investoje per nje nderhyrje te tille. Pasi kalon disa metra pa marre fryme per shkak te eres se keqe, perballesh me nje tjetër problem, me te ashtuquajturen pika e kalimit kufitar Shkoder-Vir Pazar. E hapur me shume buje me teper se nje vit me pare nga ministra e qeveritare te dy vendeve fqinje, kjo pike kalimi nuk ka funksionuar asnjehere e vetme. Funkzioni i vetem i saj ka qene bllokimi i gjysmes se shetitores. Gjysma e rruges eshte e me shirit kuq e bardhe, si ne kohe lufte dhe diku prane ndodhen dy police qe duken si figurante, pasi realisht nuk kane asnje pune per te bere. E ndersa behen konferenca te shumta, takime, madje caktohet dhe nje dite e vecante per Liqenin e Shkodres, ai vazhdon te "vdese" perdite per shkak te harreses se plote. Pasi kalon uren e Bunes, e cila vazhdon te prese e percjelle me mijera kalimtare gjersa te perfundoje ura e re perballesh me nje rruge te ngushte, mbi te cilen eshte hedhur nje shtrese asfalti qe ne fushaten elektorale te vitit 2005. Nese deri ne Shiroke shkohet jo me shume probleme, mundimi i vertete shfaqet kur vazhdon udhetimin buze liqenit te Shkodres, deri ne Zogaj. Aksi rrugor qe te con ne kete pike turistike eshte jashte cdo parashikimi i ngushte. Ka zona, ku dy makina nuk mund te nderrohen, ndaj duhen minuta te tera per te zhbllokuar kalimin. Gjate gjithë bregut te liqenit te Shkodres ka mbeturina te hedhura nga lokalet e ngritura pa kriter ne keto vitet e fundit. Pervец ndotjes se madhe te ujerave te tij vazhdon te jete problem dhe gjuetia e paligjshme e peshkut. Dhjetera peshkatore te palicencuar po zhdukin llojet me te vecanta te peshqve qe gjenden ne kete liqen.

Ndotja e ujit, 5 mije banore ne rrezik epidemie
Bledar Shehu, gazeta Korrieri

Prej nje jave, specialistet e ujesjellesit ne qytetin e Gjirokastrës po punojne per shmangien e nje defekti ne linjat e shperndarjes, i cili per shkak te ndotjes se ujit rrezikon shendetin e banoreve. Ditet e fundit, specialistet e higjienes ne rrethin e Gjirokastrës kane dhene alarmin ne lidhje me situaten e ndotjes se ujit te pijshem qe konsumohet ne rubinetet e familjeve gjirokastrite. Sipas analizave te kryera nga ana e specialisteve te shendetit publik, ne disa zona te qytetit uji qe konsumohet nga

popullata rezulton me nje shkalle me te larte ndotjeje se normalja. "Ne jemi mjaft te shqetesuar kryesisht per situaten bakteriologjike dhe higjienike te ujit qe konsumohet ne pjesen e poshtme te qytetit, e cila eshte edhe zone me e populluar", thote mjeku mikrobiolog ne Drejtorine e Shendetit Publik ne Gjirokaster, Spiro Naka. Sipas tij, gjate analizave laboratorike te kryera ne lidhje me situaten higjienike te ujit qe konsumohet nga popullata ne lagjen "18 Shtatori", ka rezultuar se ai eshte i ndotur. Behet fjale per nje nga zonat me popullsi me te dendur ne qytet. Jane rreth 5 mije banore ne lagjen "18 Shtatori", shendetit i te cileve rrezikohet si shkak i konsumit te ujit te ndotur nga rrjeti i ujesjellesit. Analizat laboratorike kane treguar se kampionet e ujit te marra ne kete zone paraqesin nje shkalle ndotjeje te rrezikshme per shendetin e popullates. "Nga ana jone, - vijon mjeku Naka, - ne kemi zhvilluar kontakte te vazhdueshme me banoret e kesaj zone, qe te mos e perdorin ujin e rrjetit te ujesjellesit per konsum te perditshem". Nderkohe, Drejtoria e Shendetit Publik ne Gjirokaster ka kerkuar edhe mbeshtetjen e Ndermarrjes se Ujesjellesit dhe pushtetit vendor ne lidhje me gjetjen e defektit dhe rikonstruksionin sa me te shpejte te kesaj linje te ujesjellesit. Prej gati nje jave, specialiste te ujesjellesit te Gjirokastrës, te ndihmuar edhe nga koleget e tyre te mberritur nga Tirana, po kerkojne per gjetjen e defektit qe shkakton ndotjen e ujit te pijshem. Ne qofte se nje gje e tille nuk do te jete e mundur, atehere drejtuesit e ujesjellesit ne Gjirokaster premtojne zevendesimin e tubacionit te kesaj linje, me qellim shmangien e problemeve shendetesore ne popullate, qe mund te krijohen si shkak i ndotjes se ujit te pijshem. Por sinjalet e dhena nga ana e specialisteve te higjienes per mosperdorimin e ujit te rrjetit te ujesjellesit ne kete zone te qytetit kane krijuar shqetesime tek banoret. Ata kerkojne rikonstruksionin sa me te shpejte te rrjetit, pasi e kane te pamundur financiarisht qe te perballojne blerjen e ujit cdo dite, aq me teper qe temperaturat e larta te kesaj vere kane rritur ndjeshem konsumin e ujit ne familjet gjirokastrite.

Vlore, qytetaret ne proteste kunder Petroliferes
Gazeta Ballkan, fq. 7

Per dy te diela radhazi qytetaret vlonjate i jane drejtuar plazhit te Triportit per te kerkuar nga qeveria ndalimin e punimeve te TEC-eve dhe te Petroliferes, qe sipas tyre jane vetem fillimi i veprave te naftes dhe gazit qe do ta shkaterrojne Vloren. As Presidenti i Republikes, as Kryetarja e Kuvendit dhe as Kryeministri nuk i jane pergjigjur Peticionit qe Aleanca u drejtoi atyre per t'u takuar deri me daten 16 shtator. Ne tre vjet komunikim as administrata dhe as organet gjyqesore nuk kane marre mundimin t'u kthejne nje pergjigje me shkrim kerkesave dhe padive te Aleances qytetare, ku denoncohen shkeljet e medha dhe te shumta te ligjshmerise. Keto citohen ne deklaraten per shtyp te Aleances Qytetare, drejtuar medias. Duke iu referuar te njejtit burim, per tre vjet me radhe qeveria Berisha ka kaluar nga premtimet e bujshme per ta bere Vloren park turistik kombetar, deri ne vendimet arrogante per te ndertuar me cdo kusht ne Plazhin e Triportit TEC-et, Petrolifera-n dhe AMBO-n.

KRUJE, Fushat e gelqeres, rrezik per banoret
Gazeta Ballkan, fq. 7

Furrat e gelqeres, prej vitesh me aktivitet ne rrethin e Krujes jane kthyer ne nje shqetesim per banoret e fshatit Halil, te cilet pohojne se kane probleme te shumta me frymemarrjen per shkak te gazrave qe clirohen ne ambient. Si lende djegese ne keto furra perdoren gomat e makinave dhe materiale te tjera plastike, te cilat gjate djegies clirojne ne atmosfere gazra helmues te demshme per shendetin. Ne baze te statistikave mjekesore 26.1% e popullates, qe jeton ne kete zone probleme te funksionimit te sistemit aspirator dhe kardiovaskular. Edhe pse Ministria e Mjedisit me date 26 maj 2006 vendosi qe

keto firma te mbyllnin aktivitetin e tyre nje gje e tille deri me sot nuk ka ndodhur.

“Largoni mbeturinat se u semurem”
Gazeta Shqiptare, fq. 11

Prej 2 vjetesh, banoret e nje blloku ne lagjen nr.4 te qytetit te Durrës, e cila ndodhet perballe murit rrethues te portit detar ankohen se jetojne mes nje pislleku te madh. Grumbuj me mbeturina inerte, vagone treni te shkaterruar dhe ndertime pa leje ne forme barakash jane ato qe te sheh syri ne kete pjese te Durrës. Ne fakt, ky eshte nje problem i ngritur edhe here te tjera, por situata ka mbetur po ajo, madje malet me mbeturina jane rritur akoma me shume. Bashkia e ka pasur te pamundur te hyje ne kete sektor, pasi territori eshte prone e Drejtorise se Pergjithshme te Hekurudhave. Madje, edhe disa objekte te transformuara si shtepi banimi jane ne inventarin e saj. Mbi kodrat me mbeturina inertesh kane mbire shkurre e barera te keqija. Nga ana e tyre, drejtuesit e Hekurudhes kane sqaruar se do te vene dore ne kete territor. Puna do te nise nga largimi i vgoneve te trenit e me pas do te vazhdoje me pastrimin. Por muajt kalojne dhe peizazhi mbetet i njejte, ne nje kohe qe banoret nuk guxojne te hapin dritaret e banesave te tyre per ajrim. U fol dhe per nje kalim te mundshemte ketij territori ne varesi te portit detar, por ajo mbeti vetem nje deklarate mirekuptimi midis ketyre dy ndermarrjeve te medha te qytetit.

NGA BOTA

Ozoni, rikuperim nga mesi i shekullit
Gazeta Shqip

Dita Nderkombetare per Mbrojtjen e Shtreses se Ozonit perkujton nenshkrimin e Protokollit te Montrealit mbi Substancat qe hollojne Shtresen e Ozonit me 16 shtator 1987, nje dite e cila u kremtua per here te pare ne vitin 1995. Studimi i fundit i NASA-s mbeshtet pikepamjen se nese protokollit i Montrealit do te zbatohet plotesisht, eshte nje mundesi e mire qe shtresa e ozonit te rikuperohet deri ne mesin e ketij shekulli. Nga pikepamja fizike shtresa e ozonit ne stratosfere sherben si nje filter perzgjedhes per rrezatimin ultraviolet qe hyn ne atmosferen e Tokes, duke i ndalur ato. Sipas te dhenave te Organizates Boterore te Meteorologjise (OBM) me 1995-n zona e prekur ka arritur permasa rekord, prej 10 milione km². Rruget kryesore ne ruajtjen dhe pakesimin e niveleve te sotme te dioksidit te karbonit ne atmosfere do te ishin ne parim burimet alternative, e kryesisht energjite e perteritshme dhe energjia berthamore. Po ashtu, nje rezerve e madhe per pakesimin e shkarkimeve te gazeve me efekt sere eshte rritja e efektivitetit te energjise ne prodhim dhe ne perdorim.

Distanca minimale fushes se misrit OMGJ nga misri tjetër 150 - 300 metra
Pershtatur ne shqip nga Lavdosha Ferruni, Shoqata e Bujqesise Organike, Tirane

Ministri gjerman i Bujqesise, Horst Seehofer, tha ne nje konference per shtyp ne korrik te ketij viti se fushat e misrit me OMGJ dhe misrit konvencional duhet te ndahen ng njerit tjetri me nje distance jo me te vogel se 150 metra. Ndersa, nese ne kufij me misrin OMGJ eshte misri organik distanca minimale do te jete 300 metra. Ne muajin Gusht (data 8) kabineti qeveritar i Gjermanise ra dakord per ndryshimin e legjislacionit te sotem te inxhinierise gjenetike, duke u bere me te ashpra. Tani, ne Gjermani po punohet per rregullat e etiketimit “pa OMGJ” per ushqimet.

Qellimi kryesor i paketës ligjore është rregullimi i praktikave për kultivimin e OMGJve dhe parandalimi i kontaminimit të bimeve jo OMGJ. Ministri gjerman theksoi se do të vazhdohet me masat për ndalimin e kontaminimit gjenetik për kulturen e patates.

Sipas ligjit të amenduar, një fermer që planifikon të mbjellë misër OMGJ duhet të informojë fermat fqinje që ndodhen brenda rrezes 300 metra nga fusha që planifikohet të mbillet me OMGJ. Fqinji duhet të pergjigjet brenda 1 muaji për të informuar fermerin OMGJ për planet e tij të mbjelljes. Fermeri OMGJ, gjatë mbjelljes, ruajtjes dhe transportit duhet të sigurojë që farat OMGJ dhe prodhimi i korrur nuk perzihen me misrin tradicional. P.sh. fermeret duhet të përdorin kontener të mbyllur dhe të pastrojnë me kujdes makinat e përdorura, para se ato të ripërdoren për farat e prodhimit tradicional. Fermeri OMGJ duhet të monitorojë fushën pas vjeljes dhe gjatë sezonit të ardhshëm të mbjelljeve se mos ka ndonjë bimë të mbire në parcelën OMGJ, që mund të kontaminojë bimen pasardhëse. Fermeri OMGJ duhet të mbajë regjister për kultivimin e bimeve OMGJ dhe masat e kultivimit. Një parcelë me misër OMGJ nuk mund të përdoret për misër tradicional se paku për dy vjet pas korrjes së misrit OMGJ.

Për të gjitha këto masa, nëse nuk respektohen, ligji parashikon pengjesi të ashpra për fermerin OMGJ, që i krijon humbje fqinjit tradicional apo organik, si rrjedhojë e kontaminimit. Dhe pengjesia qëndron edhe nëse nuk provohet fajësia e tij.

Regjistri publik për fushat me OMGJ do t'i japë mundësinë njerezve të shohin vendndodhjen e saktë të fushave. Por kritikët thonë se ky rregull ka treguar që është shumë e lehtë për njëzë të tjerë që duan t'i shkatërronë fushat me OMGJ, t'i identifikojnë ato nepermjet regjistrimit.

Neqoftesë në misrin OMGJ konstatohet OMGJ, ky prodhim nuk mund të lejohet as si ushqim për njëzë të tjerë dhe as si ushqim për kafshët, por vetëm si lëndë për biogaz.

Se shpejti ministri i Bujqësisë i Gjermanisë, Seehofer do të prezantojë ligjin që lehtëson prodhuesit e ushqimeve me origjinë shtazore, vecanërisht mish e qumësht, të shesin produktet e tyre me etiketën "Pa OMGJ". Kriteret për këto duhet të jenë në një linjë me Rregulloren e re Evropiane për prodhimin organik.

Akti i amenduar për inxhinierinë gjenetike në Gjermani bëhet funksional në mbjelljet e pranverës së vitit 2008.

Burimi: Siguria OMGJve, Gjermani <http://www.gmo-safety.eu/en/news/579.docu.html>

Shkrin akulli, hapet korridori detar në Arktik
Gazeta Korrieri, fq. 19

Korridori veriperendimor i lundrimit në Arktik është hapur plotësisht, për shkak të shkrirjes së akullit të detit, një gjë e kërkuar prej kohësh, duke hapur kështu një itinerar historikisht të pakalueshëm midis Evropës dhe Azisë, njoftoi Agjencia Hapësinore Evropiane.

Akulli i detit është tkurrur në Arktik në nivelin e tij me të ulet, që kur filluan matjet satelitore 30 vjet më parë, njoftoi ESA, duke treguar pamje të korridorit "plotësisht të lundrueshëm" midis Atlantikut dhe Paqësorit. Një itinerar lundrimi neper korridorin veriperendimor në Arktikun kanadez është çilesuar nga shumë detare si një opsion i mundshëm, me pak i kushtueshëm, për të shkuar në Kanalin e Panamës. "Kemi parë zonën e mbuluar nga akulli tani me një sipërfaqe të zvogëluar në vetëm 3 miliona kilometra katrorë", deklaroi Leif Toudal Pedersen nga Qendra daneze Kombëtare Hapësinore, duke e përshkruar zvogëlimin e sipërfaqes së akullit të Arktikut si gjendje "ekstreme". Korridori verilindor nepermjet Arktikut rus vazhdon të jetë pjesërisht i bllokuar, por duke u bazuar në zhvillimet me të fundit mund të hapet më shpejt nga ç'është menduar, deklaroi Pedersen.

Rajonet polare janë shumë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të klimës, njoftoi ESA, duke vënë në dukje

se disa shkencetare kane parashikuar se Arktiku do te clirohet nga akujt ne vitin 2040.

Njoftime

REC Shqiperi: Vend pune prane projektit te Liqenit te Shkodres

Pozicioni: Asistent/e Projekti

Kuadri i punes:

- ndihmese ne organizimin e takimeve dhe aktiviteteve te tjera ne kuader te projektit
- ndihmese ne punen e zyres per fotokopje, skedime, shkrim dhe pergatitje materialesh

Pervoja dhe aftesite e kerkuara:

- Shkollim i larte. Shkollimi dhe njohurite per mjedisin do te shihen si perparesi e kandidatit
- Pervoje e meparshme pune ne projekte
- Aftesi te mira te punes ne kompjuter (Word, Excel)
- Njohje e mire e gjuhes angleze (me shkrim dhe te folur)
- Aftesi per te punuar ne grup dhe ne disa projekte njekohesisht.

Aplikimet duhet te permbajne:

- Leter interesi per punesim;
- Nje biografi personale; dhe
- Fotokopje te dokumentacionit qe tregon permbushjen e kerkesave te mesiperme.

Personi i perzgjedhur do te punoje prane Qendres Rajonale (REC), Zyra e Projektit ne Shkoder.

Dorezimi i aplikimeve: deri me 20 shtator 2007, prane:

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)
Zyra e Projektit ne Shkoder
Lgj. Qemal Stafa, Rr. Vasil Shanto P. 23, Shkoder
Tel/faks: (022) 47 203

ose

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)
Zyra ne Shqiperi
Rr. Ismail Qemali, Nr.21, Tirane
Kutia Postare 127
Tel/faks: (04) 232 928

seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise dhe UNDP Shqiperi do te organizojne seminarin permbylles "Shqiperia – Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit" (NCSA) ne 27 Shtator, 2007, ne Hotel "Tirana International".

Seminari fillon ne oren 10:00.

Plani Strategjik i Veprimit eshte mbeshtetur ne fushat e perbashketa te tre Konventave te Rios, permes vleresimit dhe analizes se nevojave prioritare te vendit per zbatimin e Konventave Globale Mjedisore dhe pasqyron ne terma praktike aktivitetet qe duhet te ndermerren per krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe te strukturave mbeshtetese me qellim menaxhimin e koordinuar e strategjik te mjedisit ne Shqiperi. Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve do te krijojte nje mjedis lehtesues per ruajtjen e biodiversiteti unik te vendit, do te lehtesoje zbutjen e vulnerabilitetit nen kushtet e ndryshimeve klimatike si dhe do te ndihmoje ne koordinimin e masave qe duhen marre per te luftuar shkretetirizimin dhe degradimin e tokes, duke ndihmuar ne te njejten kohe zbatimin e parimeve te zhvillimit te qendrueshem.

Pjesemarresit e seminarit jane perfaqesues te Ministrive te linjes, institucioneve kerkimore dhe arsimore, eksperte kombetare, OJF, si dhe perfaqesues te institucioneve financuese.

Per me shume informacion kontaktoni:

Klodi Marika

NCSA/SLM

Manager

klodi.marika@undp.org

KONFERENCE MBI STRATEGJINE NDERSEKTORIALE PER ZHVILLIMIN RAJONAL
18 Shtator, Hotel Sheraton

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes ka udhehequr procesin e pregatitjes se draft-dokumentit te Strategjise Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal (SNZHR).

Kjo strategji eshte identifikuar si nje nevoje e Qeverise se Shqiperise per nje politike rajonale te integruar e koherente, bazuar ne shqetesimin e saj ne rritje per boshlleqet qe po thellohen gjithnje e me shume ne performancen social-ekonomike dhe pasurive ndermjet pjeseve te ndryshme te vendit. SNZHR eshte menduar si nje element kyc i Strategjise se re Kombetare per Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Ky dokument do te perdoret nga ministrite e linjes ne te ardhmen ne pergatitjen e strategjive te tyre sektoriale, si dhe nga qarku e autoritetet vendore ne pergatitjen e strategjive te zhvillimit te qarkut.

Ne kete kuader, Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, me sponsorizimin e Prezences se OSBEse ne Shqiperi, organizon Konferencen permbyllese te procesit te diskutimit dhe te formulimit te draftit final te SNZHR.

Konferenca do te mbahet ne daten 18 shtator 2007, ne oren 09.30 ne Hotel Sheraton, ne Tirane.

Ne kete konference priten te marrin pjese perfaqesues te Keshillit te Ministrave, Ministrise se Brendshme, anetare te Keshillit te Partneritetit Kombetar per Zhvillimin Rajonal, donatore dhe perfaqesues te Ministrise se Detit, Turizmit, Transportit dhe Zhvillimit te Kroacise.

Drafti final i dokumentit te SNZHR eshte publikuar ne website-in e METE (www.mete.gov.al, rubrika "Politikat" Programimi Strategjik).

Per me shume informacion mund te kontaktoni:

Thoma RUSHA Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes

thrusa@mete.gov.al

EarthCorps International Program - International Outreach Trainee Position Announcement

Position description

The International Outreach Trainee position is a training level, seasonal position in EarthCorps. EarthCorps provides environmental restoration training to emerging leaders, along with leadership training, community service and multicultural understanding of local and global issues. The Outreach Trainee's two primary responsibilities are to facilitate field projects for community and agency partners within the EarthCorps Outreach division and to gather and develop materials to start or support an environmental outreach program in his/her home country. This position reports to the Outreach Program Manager.

Duties and responsibilities

Professional Networking and Workshops:

- Participates in structured series of field, workshop, and classroom trainings. Training will focus on ecological restoration and stewardship, environmental education and youth leadership development.

Youth and Community Outreach Projects:

- Community events at various sites in the Seattle area & special Earth Month events in April.

International Project:

- Writes Individual project proposal in conjunction with sponsored NGO.
- Researches and carries out fundraising opportunities to support project.

Program Support & Administrative:

- Assists other EarthCorps programs/staff as assigned.
- Attends all required staff meetings.
- Completes necessary paperwork in a timely manner. (Training logs, timesheets, etc).
- Prepares oral and written reports of training projects, equipment use and maintenance, project reports and incident reports.

Project Implementation:

- Develops and implements outreach programming and field projects in conjunction with field staff, as well as with community and government agencies.
- Facilitates restoration-based service-learning programs.
- Trains volunteers in environmental restoration techniques.

Training Supervision:

- Maintains appropriate standards of behavior, policies and procedures of EarthCorps.
- Provides leadership and direction in support of program goals and mission.
- Assists in counseling, motivation and discipline of individual program participants.

Communication:

Supports efforts of EarthCorps.

Promotes the health and well being of EarthCorps, staff and corpsmembers in all communications.

Resolves issues/concerns directly with EC staff/corps members or that person's supervisor.

Outreach trainee's terms of service

Status: Volunteer, temporary

Period of training: mid January, - mid December, 2008

Stipend: \$360 / month

Hours of training: 7:30 am – 5:00 pm Mon-Fri; approx. every other Friday off

3-4 multi-day program retreats outside of Seattle throughout program

Possible camping for 2-3 weeks of program

Benefits:

Travel Insurance premium paid for volunteer only.

Bus passes provided during term of service

Airfare to and from Seattle may be partially paid by EarthCorps

Homestay family in Seattle (provides a private bedroom and meals)

Boots, pant, T-shirt and rain gear provided

Required qualifications

5 years practical experience in the environmental field

-Or-

4 years post secondary education, plus one year of work experience in a field related to the environment.

- Interest in environmental fieldwork, intercultural knowledge and educational activities
- Commitment to teamwork with peers from around the world
- Desire to engage in service learning
- Support from a sponsoring organization
- Conversational English
- No Criminal Record

To apply

Candidates should be referred to EarthCorps by an environmental organization (i.e. NGO, LGU, community group or student club).

Materials are available online at: http://www.earthcorps.org/join_international.php.

Application materials will be sent for the candidate upon confirmation of the referring organization. Referring organizations should have completed the Partner Application Form and send the Candidate Nomination to: mark@earthcorps.org

Deadlines and start dates:

- **Application Deadline: September 21, 2007**
- Participant selection: October 2007
- Visa processing: October 2007 - December 2007
- Travel confirmation: January 4, 2008
- EarthCorps Program starting date: mid-January 2008
- EarthCorps Program graduation: mid-December 2008

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditor do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>
www.mjedisisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimpruese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
